



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 284/1 prot.

Tiranë, më 22.02.2019

**VENDIM**  
**Nr.17, datë 22.02.2019**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË**  
**VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 238, DATË 13.12.2017, NË**  
**INSTITUCIONIN E BASHKISË MALIQ**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit dhe Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 238, datë 13.12.2017, “Mbi miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Maliq dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, në Bashkinë Maliq,

**KONSTATOVA SE:**

Bazuar në programin e verifikimit nr. 405/1 prot., datë 13.04.2018, “Për verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit nr. 238, datë 13.12.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Maliq dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, Komisioneri ka nisur verifikimin ligjshmërisë së veprimit administrativ të Vendimit nr.238, datë 13.12.2017, të KMSHC, njoftuar institucionit me shkresën nr. 405/2 prot, datë 13.04.2018, “Për fillim verifikimi”.

Ky proces u realizua nëpërmjet verifikimit të situatës në institucion, në përfundim të të cilit grupi i punës përpiloi edhe një Akt – Konstatimi, nga përmbajtja e të cilit vërejt se:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas përfundimit të mbikëqyrjes, ka dërguar pranë Bashkisë Maliq Raportin Përfundimtar lidhur me administrimin e shërbimit civil dhe Vendimin paralajmërues nr.238, datë 13.12.2017, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës, si dhe një afat prej 30 ditësh për zbatimin e tyre.

Mbështetur në gjetjet e specifikuar në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, si dhe në detyrat e lëna për Bashkinë Maliq, në përmbajtjen e vendimit paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë, pas verifikimit në subjekt të veprimeve administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, konstatohet se situata aktuale e administrimit të shërbimit civil, e specifikuar sipas radhës së detyrave në vendim, rezulton si më poshtë:

✓ Në pikën 2 të Vendimit paralajmërues të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është kërkuar nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Maliq të konstatohet menjëherë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit dhe të rregullojë pasojat, duke ndërprerë marrëdhëniet financiare me institucionin, për 5 punonjësit e emëruar në kundërshtim me ligjin.

Nga shqyrtimi i akteve të administruara gjatë verifikimit në subjekt, konstatohet sa më poshtë:

Për punonjësin \*\*\*\*\*:

- 1- Me Urdhrin nr. 118/1, datë 05.03.2018, është konstatuar pavlefshmëria absolute e Urdhërit Nr. 454 datë 11.10.2016, për emërim në pozicionin e punës “*Punonjës Social/Specialist në Njësine Administrative Gorë*”.
- 2- Me aktin nr. 138 prot., datë 11.01.2018, është bërë shpallja vakant e këtij pozicioni pune.
- 3- Në përfundim të procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 9158 prot., datë 05.03.2018, është bërë emërimi i këtij punonjësi si nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin e mësipërm.

Për punonjësen \*\*\*\*\*:

- 1- Me Urdhrin nr. 1765/1, datë 04.05.2018, është konstatuar pavlefshmëria absolute e Urdhërit Nr. 32 datë 19.05.2014, për emërim në pozicionin e punës “*Specialiste e Ndihmës Ekonomike në Sektorin e Mirëqenies Sociale*”.
- 2- Në përfundim të procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 1763 prot., datë 04.05.2018, është bërë emërimi i kësaj punonjëseje si nëpunëse civile në periudhë prove në pozicionin e punës “*Punonjës Social*” pranë Bashkisë Maliq.

Për punonjësin \*\*\*\*\*:

- 1- Me Urdhrin nr. 208/1, datë 04.05.2018, është konstatuar pavlefshmëria absolute e Urdhërit Nr. 97, datë 28.03.2017, për emërim në pozicionin e punës *Specialist për Emergjencat Civile* në Bashkinë Maliq.
- 2- Me aktin nr. 1215 prot., datë 26.03.2018, është bërë shpallja vakant e këtij pozicioni pune.
- 3- Në përfundim të procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 1764 prot., datë 04.05.2018, është bërë emërimi i këtij punonjësi si nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin e mësipërm.

Me Urdhrin nr. 06, datë 04.01.2018, *“Për strukturën emërore, nivelin e pagave të administratës së Bashkisë (qendër), Njësi Administrative dhe Agjencie të Bashkisë Maliq për vitin 2018”*:

- punonjësja \*\*\*\*\* , emëruar në kundërshtim me ligjin me aktin administrativ nr. 294, datë 16.06.2016, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin e punës, *“Specialist/Arkivist, në Drejtorinë Juridike dhe të Prokurimeve”*, ka kaluar *“Punonjëse Protokoll”*, pozicion pune që nuk përfshihet në shërbimin civil;
- punonjësi \*\*\*\*\* , emëruar në kundërshtim me ligjin me aktin administrativ nr. 343/15, datë 22.07.2016, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin e punës *“Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Mbledhjes së Taksave, në Drejtorinë e të Ardhurave”* ka kaluar në *Punonjës Licensimi – Biznesi ( i QKB)*, pozicion pune që nuk përfshihet në shërbimin civil.

✓ Në lidhje me pikën 3 të Vendimit nr. 238, datë 13.12.2017, të Komisionerit, në të cilën është kërkuar konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit të emërimit për ngritjen në detyrë të punonjësës \*\*\*\*\* , ndërpreja e marrëdhënieve të punës dhe asaj financiare dhe shpallja e vendit vakant të pozicionit të punës *“Përgjegjës Tatim-Taksash, Regjistrim+Llogaritje, në Zyrën e Tatim Taksave, Njësia Administrative Pirg”*, konstatohet se:

Me Vendimin nr.31, datë 04.05.2018, të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore është konstatuar pavlefshmëria absolute e aktit të emërimit nr. 1450 prot, datë 20.03.2017, të punonjësës \*\*\*\*\* në pozicionin e punës, *“Përgjegjës në Tatim Taksash, Rregjistrim+ Llogaritje në Zyrën e Tatim Taksave, Njësia Administrative Pirg”*.

Me aktin nr. 1215 prot., datë 26.03.2018, është bërë shpallja vakant e këtij pozicioni pune *(i cili me strukturën e miratuar me Urdhrin nr. 06, date 04.01.2018, është emërtuar “Inspektor Taksash”)* dhe në përfundim të procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 1762 prot., datë 04.05.2018, të njësisë përgjegjëse të institucionit,

punonjësja \*\*\*\*\* është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “Inspektor Taksash, Njësia Administrative Pirg”.

✓ Në lidhje me pikën 4 të Vendimit nr. 238/2017, të Komisionerit, në të cilën është kërkuar konstatimi i pavlefshmërisë absolute të akteve të transferimit të punonjësve \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, sistemimi i tyre në një pozicion të së njëjtës kategori (*Specialist*) me pozicionet të cilat i mbanin në momentin e ristrukturimit dhe shpallja si të lira të pozicioneve të punës të zëna prej tyre në kundërshtim me ligjin (“Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Mirëqenies Sociale, në Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve” dhe “Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Aseteve, në Drejtorinë Financës dhe Buxhetit”) për t’i plotësuar më tej në përputhje me ligjin, konstatohet se:

- Me Vendimin nr.1/1, datë 05.03.2018, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të aktit të transferimit nr. 22 prot., datë 31.08.2015, të punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Mirëqenies Sociale”.
- Me Vendimin nr. 1/2, datë 05.03.2018, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të aktit të transferimit nr. 3430 prot., datë 22.07.2016, të punonjësës \*\*\*\*\* në pozicionin e punës “Përgjegjëse Sektori, në Sektorin e Aseteve, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit”.

Më tej, këta dy punonjës i janë nënshtruar procedurës së konkurrimit për ngritjen në detyrë (*janë administruar të gjitha aktet që materializojnë realizimin e procedurës së ngritjes në detyrë për të dy rastet*). Në përfundim të kësaj procedure, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktet e mëposhtme:

- Aktin nr. 902 prot, datë 05.03.2018, për emërimin si nëpunës civil të \*\*\*\*\* në pozicionin e punës “Përgjegjës në Sektorin Social dhe Strehimit”, në Bashkinë Maliq.
- Aktin nr. 903 prot, datë 05.03.2018, për emërimin si nëpunës civil të \*\*\*\*\* në pozicionin e punës “Përgjegjës në Sektorin e Buxhetit”, në Bashkinë Maliq.

✓ Në lidhje me rekomandimin për plotësimin e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil (pika 5 e vendimit paralajmërues), konstatohet se:

Njësia përgjegjëse ka zbatuar rekomandimin sipas orientimit të lënë në Raportin Përfundimtar të Mbikëqyrjes dhe në Vendimin e paralajmërimit nr. 238, datë 13.12.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Konkretisht, në dosjet e personelit për çdo nëpunës civil, janë përfshirë, të gjitha dokumentet dhe të dhënat sipas lidhjeve 1 e 2, pjesë e vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit

*qendror të personelit*”, si dhe ato të evidentuara në mungesë në tabelën aneks nr. 2, e cila është pjesë e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Nga gjithë sa u analizua më sipër, arrij në konkluzionin dhe vlerësoj se pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin nr.238, datë 13.12.2017, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Maliq dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*, të Komisionerit, nga ana e institucionit të Bashkisë Maliq dhe e Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore janë realizuar plotësisht rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 238, datë 13.12.2017, *“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ekzekutimit të vendimit nr.238, datë 13.12..2017”*, në Bashkinë Maliq.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njesisë përgjegjëse të institucionit të Bashkisë Maliq, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 238, datë 13.12.2017.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Maliq.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**